



Prishtinë, 16 prill 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1137_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave për Furnizuesin me Shërbim Universal (Rregulla për të Hyrat e FSHU);
- Vendimin Nr. V_1127_2019 të datës 28 mars 2019 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin e Shërbim Universal (FSHU/KESCO SH.A.);
- Kërkesën/propozimin e KESCO SH.A. - Furnizuesit për Shërbime Universal për strukturën tarifore, të dërguar 08 prill 2019 në ZRRE, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike,

në seancën e mbajtur më 16 prill 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me Shërbime Universale të Furnizimit, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., duke filluar nga data 1 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.
- II. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me Shërbime Universale të Furnizimit është në përputhje me Kreun VII., Metodologjia për Strukturën Tarifore të "Rregullës për të Hyrat e FSHU" të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së.
- III. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët me Shërbime Universale të Furnizimit, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2019, është paraqitur në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Tabela: Tarifa me pakicë e Energjisë Elektrike për konsumatorët e rregulluar tarifor:

| Grupi Tarifor | Niveli i tensionit të furnizimit | Elementi Tarifor | Njësia | Koha gjatë ditës | Aprovuar 2019 |
|---------------|---|------------------------------------|-------------------|------------------------------------|---------------|
| 1 | 35kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 11.19 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW/muaj | | 5.85 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 4.92 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 3.16 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.67 |
| 2 | 10kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 4.62 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW | | 5.04 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 5.73 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 3.69 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.67 |
| 3 | 0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.57 |
| | | Fuqia e angazhuar | €/kW | | 2.97 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.69 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 4.96 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €/kVArh | | 0.67 |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 2.97 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e vetme | 8.83 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Lartë | 10.71 |
| | | | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh |
| 5 | 0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 1.74 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e Lartë | 6.75 |
| | | | €/kWh | Tarifë e Ulët | 2.89 |
| 6 | 0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 1.74 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | | 5.32 |
| 7 | 0.4kV (familjarë pa matës) | Konsumi i vlerësuar: | | | |
| | | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 1.74 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë mesatare | 6.75 |
| 8 | Ndriçimi Publik | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/muaj | | 3.21 |
| | | Energjia aktive (P), prej së cilës | €/kWh | Tarifë e vetme | 9.24 |

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
 Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
 Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

ARSYETIM

- ZRRE me datë 08 prill 2019 nga KESCO SH.A. (Furnizuesi për Shërbime Universal) ka pranuar kërkesën/propozimin për Strukturën Tarifore në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike.
- ZRRE me rastin e përcaktimit të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me Shërbime Universale të Furnizimit, ka marrë parasysh dokumentet që janë përgatitur, lëshuar dhe publikuar në faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:


- Raportin Konsultativ për të Hyrat e Lejuara Maksimale Furnizuesi me Shërbim Universal (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin shkurt 2019;
- Raportin Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT SH.A.(prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin shkurt 2019;
- Raportin Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KEDS SH.A (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin shkurt 2019;
- Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU(KESCO SH.A.) dhe përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin prill 2019;
- Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSTOT-së, dhe përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin prill 2019; dhe
- Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OSSH-së, dhe përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020), i publikuar muajin prill 2019.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, i cili dhe do të zbatohet nga KESCO SH.A. - Furnizuesi i Shërbimit Universal(FSHU), duke filluar nga data 01 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

Furnizuesit me Shërbim Universal (KESCO), dhe
Arkivit të ZRRE-së